

Përmbajtja

Hyrje	05
SEKSIONI I	
Ankesa me objekt "cenimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit"	07
SEKSIONI II	
Ankesa me objekt "cenimin e të drejtave të fëmijëve"	41
SEKSIONI III	
Ankesa jashtë juridiksionit	51
SEKSIONI IV	
Ankesa jashtë afatit	74
SEKSIONI V	
Komunikime tregtare	79
SEKSIONI VI	
Ankesa të ndryshme dhe kerkese per informacion	83

Hyrje

Buletini i 19-të i Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive paraqet një përmbledhje të ankesave të administruara gjatë periudhës korrik–dhjetor 2025. Në këtë material referohen tendencat kryesore të raportimit, temat më të shpeshta të problematikave të evidentuara në përmbajtjet audiovizive, si dhe qasjen e ndjekur në shqyrtimin dhe vendimmarrjen e Këshillit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet etike në fuqi.

Gjatë vitit 2025, Këshilli i Ankesave ka administruar gjithsej 430 ankesa, ku pjesa dërrmuese e tyre është paraqitur nga individë, duke dëshmuar një nivel të lartë angazhimi qytetar në përdorimin e mekanizmave të ankimit pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ankesat janë përqendruar kryesisht në çështje që lidhen me cenimin e figurës dhe dinjitetit (26,1%), privatësinë dhe të dhënat personale (15,4%), si dhe në shkelje të standardeve editoriale, etike dhe profesionale. Një pjesë e konsiderueshme e ankesave ka pasur gjithashtu si objekt pamje ose skena dhune, interesin më të lartë të fëmijës

dhe të drejtën për t'u harruar, duke reflektuar ndjeshmërinë në rritje të publikut ndaj përmbajtjeve me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat individuale.

Administrimi i ankesave gjatë kësaj periudhe është karakterizuar kryesisht nga masa me natyrë verifikuese, korigjuese dhe parandaluese. Në një pjesë të rasteve, Këshilli i Ankesave ka kërkuar paraqitje pretendimesh ose ka ndërmarrë tërheqje vëmendjeje, ndërkohë që masat ndëshkuese, përfshirë sanksionet financiare, janë aplikuar vetëm në raste të kufizuara, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe funksionin rregullator të Autoritetit. Në një numër jo të vogël rastesh, vendimmarrja ka shkuar në favor të lirisë editoriale, duke konstatuar mbizotërimin e lirisë së shprehjes ndaj pretendimeve të paraqitura.

Për Këshillin e Ankesave si strukturë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ka qenë gjithmonë e rëndësishme, ruajtja ekuilibrit mes respektimit të lirieve dhe të drejtave të njeriut por edhe promovimi i lirisë së shprehjes, si

kushte themelore për funksionimin e demokracisë në vend. Nga njëra anë roli i medias audiovizive në informimin e shoqërisë, formimin e opinionit publik dhe edukimin qytetar, duke qenë një aktor kyç në funksionimin e një shoqërie demokratike. Nga ana tjetër mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut, nderit dhe dinjitetit të tij në përmbajtjet audiovizive. Këto dinamika e bëjnë edhe më të rëndësishëm respektimin e standardeve profesionale, etike dhe ligjore, si dhe ruajtjen e një balance të drejtë mes interesit publik, lirisë

editoriale dhe të drejtave themelore të njeriut.

Ndaj dhe në fokus të punës dhe rolit të Këshillit të Ankesave si një urë lidhëse mes publikut, Ofruesve të Shërbimeve të Mediave Audiovizive (OSHMA) dhe organeve vendimmarrëse të Autoritetit të Mediave Audiovizive, ka kontribuar në rritjen e transparencës, forcimin e përgjegjshmërisë editoriale dhe ndërtimin e një dialogu të vazhdueshëm ndërmjet mediave dhe publikut që ato shërbejnë.

1

Ankesa me objekt

"cenimin e rregullave

të etikës dhe dinjitetit"

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.M.	Report tv	"Pa Gjurëm"	04.07.2025

1. Objekti i Ankesës

F.M i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave, me objekt emisionin "Pa Gjurëm" në Report TV ku trajtohej një çështje pronësie trualli. Ankuesi akuzonte drejtuesi e emisionit për njëanshmëri.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e z.F.M dhe verifikoi përmbajtjen e emisionit "Pa Gjurëm" në Report tv ku ankuesi pretendonte se drejtuesja e emisionit mori në mbrojtje një person që sipas z. F.M i kishte dëmtuar rëndë familjen dhe se përmes këtij emisioni po përpiquej të manipulonte opinionin publik.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim, Këshilli i Ankesave i njohu zotit F.M të drejtën e përgjigjes sipas nenit 53 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Dhe në vijim, i kërkoi

drejtueses së emisionit "Pa Gjurëm" në Report Tv, që bazuar në reagimin e ankuesit F.M në vijim të përgjigjes suaj si edhe në verifikimin e përmbajtjes audiovizive nga ana e Këshillit të Ankesave pranë AMA-s, ankuesi nuk ka pasur mundësi të mjaftueshme, për të paraqitur faktet dhe qëndrimin e tij ndaj çështjes në diskutim.

Ky konstatim nuk prekte përmbajtjen apo themelin e çështjes, pasi Këshilli i Ankesave (KA), si pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), nuk ka kompetencë ligjore për të prodhuar një gjykim mbi konfliktin pronësor ndërmjet palëve. KA ka kompetencën dhe detyrimin ligjor për të garantuar trajtimin e barabartë të palëve nga media, në diskutimin e çdo çështjeje me interes publik, përfshirë dhe ato që lidhen me pronësinë apo konfliktet mbi pronën.

Sipas nenit 53 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, çdo individ, "dinjiteti dhe reputacioni i të cilit janë prekur nga publikimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta në një transmetim, ka të drejtën e përgjigjes".

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
M.Gj.	You Tube	"Pa Gjurmë"	08.07.2025

1. 1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e z. M.Gj mbërritur pranë institucionit tonë me objekt përmbajtjen e emisionit "Pa Gjurmë" në platformën YouTube.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e z.M.Gj i cili pretendonte se në kanalin YouTube të gazetares Odeta Dume ishte publikuar një material audioviziv që fliste për ankuesin por transmetimi, sipas ankuesit, ishte bërë pa pëlqimin e ankuesit dhe se përmbajtja e këtij

materiali ishte e dëmshme për të. Z. M. Gj kërkonte që kjo video të hiqej nga platforma YouTube dhe të mos përsëritet më një rast i ngjashëm.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe konkretisht nenit 2, "Fusha e zbatimit", "Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre", ankuesit iu bë me dije se mediat online dhe portalet janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Gj.Sh.	MVN	Fol	08.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Gj. Sh i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me përmbajtjen audiovizive të emisionit "Fol", transmetuar në MCNTV.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave administroi ankesën e z.Gj. Sh nga ku evidentoi se "Emisioni "Fol", transmetuar në televizionin "MCNTV" trajtohej pronësia dhe strehimi, plagë të madhe e shoqërisë shqiptare dhe një teme më ndjeshmëri të lartë. Përmes bashkëbisedimit të banorëve të këtyre objekteve dhe pretenduesit të pronësisë vijon një konflikt, i cili po shqyrtohet nga sistemi i drejtësisë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se, komunikimi i mësipërm përbënte shmangie prej Ligjit nr.97/2013 "Për

mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në:

- nenin 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 2/dh: "moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën",
- nenin 46, "Kodit të Transmetimit", pika 2/c: "OSHMA-të të mos transmetojnë programe që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik...",

si dhe

Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023 i amenduar me vendimin nr.107, datë 11.11.2024, në:

- -seksionin 3, pika 3.9: "OSHMA-të... nuk promovojnë për qëllime sensacionale, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhunën",
- -seksioni 5, pika 5.31: "Duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të

fëmijëve".

Për sa më sipër, pavarësisht, se shkelja parësore u takonte institucioneve dhe me të drejtë trajtimi i temave të tilla përbën interes të gjerë publik, dhuna nga media nuk duhej kurrsesi drejtpërdrejtë apo tërthorazi të perceptohet si një mjet i pranueshëm për zgjidhjen e konflikteve, gjë që

dëmton rendin dhe ligjin. Ndaj dhe Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ankuesi dhe këqyrjes së përmbajtjes audiovizive i tërhoqi vëmendjen për mënyrën e trajtimit të çështjes dhe rishikimin e saj në përputhje me ligjin për mediat.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.Ç.	Vision Plus	"Emisioni 7pa5"	08.07.2025

1. 1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë nga A. Ç lidhur me emisionin "7pa5", të transmetuar në televizionin "Vizion Plus", më datë 07.05.2025.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e z. A.Ç i cili pretendonte se deklaratat e katër pjesëmarrësve në emision ishin të pabazuara në ligj, prova apo fakte konkrete dhe përmbajnë shpifje ndaj tij si dhe ndaj institucioneve të drejtësisë,

konkretisht prokurorisë dhe gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës dhe përgjigjes së administruar, Këshilli i Ankesave vlerësoi se në këtë rast zotit A.Ç i lind e drejta për të ushtruar "të drejtën e përgjigjes", në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe për të paraqitur qëndrimin tuaj në të njëjtin televizion, "Vizion Plus".

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
E.Z.	Top Channel	Lajm	08.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e znj E. Z lidhur me televizionin "Top Channel".

2. Administrimi i Ankesës.

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e znj. E. Z e cila pretendonte se televizioni "Top Channel", kishte publikuar një lajm në lidhje me çështjen e z. F. Muçllarit dhe se në përmbajtjen e këtij lajmi ishte publikuar "një fotografi që i përket profilit të Facebook-ut të vëllait të saj, ku në të njëjtën foto shfaqet

ajo personalisht", pa dakordësinë apo autorizimin e saj.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-së "Top Channel", paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e tij. Në kthim përgjigjen e tyre, OSHMA bënte me dije se kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës në përmbushje të të gjitha detyrimeve ligjore duke hequr fragmentin (fotografinë e cituar). Sa më sipër, rezultoi se OSHMA-ja kishte reaguar duke ndërmarrë veprimet / korrigjimet në përmbajtjen audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.B.	Top Channel	Për'puthen	21.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë nga A.B me objekt emisionin "Për'puthen", të transmetuar në televizionin Top Channel.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e shtetasit A.B i cili pretendonte se *"formati i programit, "Për'puthen", në Top Channel për shkak të gjuhës së përdorur dhe skenave të natyrës sensuale, mund të ndikojë negativisht tek të miturit dhe, në përgjithësi, në perceptimin dhe sjelljen e publikut të ri"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive, përmes Bordit të tij dhe strukturave

përgjegjëse, në bazë të funksionit rregullator që ushtron, monitoron në mënyrë të vazhdueshme tregun audioviziv, si në tërësi, ashtu edhe në veçanti për formatet e referuara nga publiku përmes ankesave.

Nisur nga fakti se ankesa shkon përtej objektit të saj të thjeshtë, me datë, orë dhe edicion të përcaktuar, rasti i referuar, bazuar edhe në të dhënat e monitorimeve, vijon të jetë në shqyrtim nga Bordi i Autoritetit me qëllim vlerësimin e përmbushjes nga ana e subjektit audioviziv të

detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Kodin e Transmetimit dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Ankueses iu bë me dije se në përfundim të këtij shqyrtimi, Autoriteti do të dalë me një qëndrim përfundimtar, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tij rregullatore.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.Ç.	Vision Plus	"Emisioni 7pa5"	14.07.2025

1. Objekti i Ankesës

A.Ç i drejtoi Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive një ankesë me objekt emisionin "7 pa 5" të transmetuar në televizionin Vision Plus.

2. Administrimi i Ankesës

Ankuesi kërkonte "shfuqizimin e akteve administrative individuale të Këshillit të Ankesave, datë 08.07.2025 dhe të Media Vizion, nr. 61/1 prot, datë 16.06.2025;- përgënjeshttrimin publik të "deklaratave" të publikuara në emisionin "7 pa 5", transmetuar në Vision Plus, më datë 07.05.2025, si dhe

- shpërblimin...me një vlerë financiare të arsyeshme nga Vision Plus...;
- kalimin në CD-në tuaj personale të emisionit "7 pa 5", të datës 07.05.2025;
- takim personal me Kryetaren e AMA-s",

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të shkresave të dërguesit dhe OSHMA-së, Këshilli i Ankesave sqaroi ankuesin se, dy kërkesat e tij si; (heqja e materialit audioviziv të kontestuar dhe ofrimi i hapësirës mediatike për përgënjeshttrim apo ushtrimin e të drejtës së përgjigjes) u ezauruan nga subjekti, në përputhje me detyrimet ligjore dhe standardet e përcaktuara në ligjin nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore përkatëse, Këshilli i Ankesave –sqaroi, se oferta e televizionit ka të bëjë ligjërisht me ofrimin e të drejtës së përgjigjes (Ligji 97/2013, "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 53) konsideron funksionin e tij të përfunduar, pasi në përputhje me ofertën e subjektit mediatik, komunikimi – të cilin, ankuesi e kishte nisur njëkohësisht me median dhe Autoritetin, do të duhej të vazhdonte me median, në përmbushje të kërkesave të parashtruara dhe të njohura nga media.

1. Për sa më sipër, administrimi i ankesës nga ana e Këshillit të

Ankesave ishte konform ligjit, rregulloreve dhe praktikave administrative përkatëse dhe rishikimi nuk ka bazë ligjore.

2. Ligji 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar – ligji organik i Autoritetit të Mediave Audiovizive, nuk parashikon "shpërblim financiar' për të "prekurit e dëmit të pretenduar", por vetëm sanksione financiare për subjektet, që nuk e njohin dhe ofrojnë mundësinë e ushtrimit të së drejtës së përgjigjes, e cila në këtë rast nuk mund të zbatohet pasi subjekti, ka shprehur me shkrim ((nr.61prot., dt.

16.06.2025, protokolluar me tonën me nr.1658/2prot., dt. 16.06.2025) gatishmërinë për të publikuar si pretendimet tuaja rreth çështjes ashtu edhe përgënjeshttrimin e pretendimeve të ngritura nga pala tjetër.

3. Kërkesa për vënien në dispozicion të përmbajtjes audiovizuale në fjalë (*emisioni "7 pa 5", transmetuar në Vizion Plus, më datë 07.05.2025*) në kushtet e fshirjes së saj nga llogaria e Vizion Plus në You Tube, sipas kërkesës suaj, miratohej dhe materiali iu hodh në CD.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.K.	Syri TV	Piranjat	03.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë nga znj.A.K me objekt "një material të transmetuar në emisionin "Piranja" në televizionin Syri TV.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës tuaj, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s shqyrtoi me kujdes përmbajtjen audiovizive përkatëse, konkretisht videon e emisionit "Piranjat", transmetuar në televizionin Syri TV.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Emisioni trajtonte rastin e një deklaratë televizive live të një kompanie private dhe pronares së kësaj kompanie. Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave nuk evidentoi fjalor fyes dhe shkelje të etikës së komunikimit gjatë raportimit të rastit në fjalë por gjykon se publikimi dhe investigimi i ngjarjes, i shërben në radhë të parë vajzës

me probleme shëndetësore si dhe informimit të opinionit publik në lidhje me një çështje mediatike e cila u bë e njohur për publikun live në formatin e reality show, BB VIP Kosova.

Informacionet e publikuara nga stafi i emisionit i referoheshin deklaratave dhe komunikimeve të palëve të përfshira në këtë çështje dhe i shërbenin zbardhjes dhe investigimit të drejtë të ngjarjes.

Referuar ligjit Nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 33, sanksionon se ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet: a) të njoftojë dhe të paraqesë lajmet e transmetuara në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive; b) të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme;

Si përfundim, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive nuk konstatoi shkelje të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.M.	Report TV	"Pa Gjurmë"	04.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit F.M me objekt *"një material të publikuar në emisionin "Pa Gjurmë" në Report TV"*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave, në zbatim të nenit 51 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të rregullores *"Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes"*, iu drejtua Bordit të Ankesave të subjektit audioviziv me një kërkesë zyrtare për paraqitjen e pretendimeve. Subjekti ka depozituar përgjigjen e tij me shkrim brenda afateve të përcaktuara me ligj, përgjigje u administrua gjatë shqyrtimit të ankesës.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Referuar kësaj përgjigjeje, emisioni në

fjalë trajtonte një konflikt pronësie, për të cilin redaksia kishte marrë informacion dhe verifikime paraprake pranë Policisë së Përmetit dhe kishte pasur në dispozicion dokumentacion ligjor dhe vendime gjyqate. Për këtë arsye, sipas redaksisë, trajtimi i çështjes ishte në funksion të informimit publik dhe jo në favor të një pale të caktuar.

Nga sa raportohej nga subjekti, ankuesi kishte qenë i pranishëm gjatë transmetimit nëpërmjet një lidhjeje të drejtpërdrejtë telefonike, e cila kishte zgjatur deri në përfundim të emisionit, dhe moderatores nuk i është dashur të ndërpresë të drejtën tuaj të fjalës, përveç ndërhyrjeve për t'ju tërhequr vëmendjen mbi përdorimin e gjuhës së papërshtatshme në transmetim live.

Gjithashtu, që gjatë transmetimit, redaksia kishte komunikuar mundësinë për të qenë i ftuar në studio në një emision pasardhës, në mënyrë që të paraqisnit në mënyrë të plotë versionin tuaj të ngjarjes. Kjo mundësi, sipas deklarimeve të redaksisë, vijon të mbetet e hapur edhe pas transmetimit të datës 04.07.2025.

Në këtë kuadër, Këshilli i Ankesave

vlerësoi se ishte respektuar parimi i së drejtës së përgjigjes, sipas nenit 53 të Ligjit nr.97/2013, duke qenë se: ju është dhënë hapësirë gjatë transmetimit për të shprehur qëndrimin tuaj; ju është ofruar sërish mundësia për të paraqitur në mënyrë më të zgjeruar versionin tuaj të ngjarjes në një emision të ardhshëm, të cilën subjekti audioviziv shprehet se

e garanton ende.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave inkurajoi ankuesin të shfrytëzonte këtë mundësi të ofruar nga subjekti, e cila përbën një formë praktike të ushtrimit të së drejtës suaj të përgjigjes dhe të ofrimit të perspektivës suaj në raport me çështjen.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Ambasada e Holandës	Top Channel MCNTV TV 6+1 Vlore, Syri TV ABC News, Drita TV	-	29.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shqipëri me objekt, raportimin mediatik të aksidentimit të një shtetase holandeze, e cila ndërroi jetë pranë Himarës, në plazhin e Filikurit.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave në AMA administroi ankesën e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shqipëri në lidhje me raportimin mediatik për vdekjen e një shtetase holandeze në plazhin e Filikurit në Himarë më datë 23 korrik 2025.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) pasi mori

në shqyrtim përmbajtjen audiovizive, konstatoi se ka pasur shmangie: nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit: o "respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private" (neni 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 2/ç); o "Në programet e transmetuara nga OSHMA-të të mos cenohet e drejta e fshehtësisë së jetës private të personit" (neni 46, "Kodi i Transmetimit", pika

2/ç); si edhe nga Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, sipas të cilit: o "OSHMA-të nuk bëjnë publik identitetin e personit që ka humbur jetën ose është përfshirë në aksident, përveç rasteve kur është konfirmuar paraprakisht, se pjesëtarët e familjes janë të informuar dhe të vetëdijshëm për situatën ose kur identiteti i viktimës është vendimtar për hetimin. Rastet përjashtimore dikton vetëm nga interesi publik."(Seksioni 2, "E drejta për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale", pika 2.9); o

"OSHMA-të tregojnë kujdes në rastet e transmetimit të informacioneve në lidhje me një krim ose aksident, duke verifikuar paraprakisht dhe me kujdes emrin e viktimës/viktimave dhe pamjet e vendngjarjes, për të shmangur fokusimin e vëmendjes së publikut te viktima dhe të afërmit e saj." (Seksioni 2, "E drejta për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale", pika 2.17).

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave, bazuar në *"Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes"*, e ndryshuar me vendimin e AMA-s, nr.56,

datë 07.07.2023, neni 6 *"Konkluzionet e Këshillit të Ankesave"*, pika 4, ju tërheq vëmendjen për shmangie nga ligji nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, dhe nga Kodi i Transmetimit (miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, i amenduar me vendimin nr.107, datë 11.11.2024), dhe kërkon: ndalimin e ritransmetimit të përmbajtjeve audiovizive të sipërpërmendura; heqjen e tyre nga kanali juaj zyrtar në YouTube, brenda një afati prej 30 ditësh.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
R.K.	Euronews Albania News24 Vizion + Top Channel	-	18.08.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasës R.K me objekt *"publikimin e të dhënave personale në mediat audiovizive duke shkaktuar dëm të imazhit për një rast të pretenduar abuzimi, me tenderat e Universitetit Bujqësor të Tiranës"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasës R.K lidhur me *"publikimin e të dhënave personale në mediat audiovizive duke shkaktuar dëm të imazhit për një rast të pretenduar abuzimi, me tenderat e Universitetit Bujqësor të Tiranës"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, në përputhje me funksionin e tij

rregullator, dispozitat e ligjit nr. 97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, si dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023, analizoi pretendimet tuaja dhe shqyrtoi përmbajtjet audiovizive përkatëse. Nga kjo analizë rezultoi se raportimet në fjalë i referohen një çështjeje me interes të lartë publik, të lidhur me hetime penale për korrupsion, të kryera nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Mediat e verifikuara janë mbështetur në të dhënat e njoftimit zyrtar të organit procedues (njoftim për shtyp i vetë SPAK), pa shtrembëruar përmbajtjen dhe – për rrjedhojë – pa cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, siç parashikohet nga ligji. Personat e përfshirë janë përmendur vetëm në kontekstin e masave të sigurisë, përfshirë edhe *"detyrimin për paraqitje"*, që ju prek ju personalisht, sipas informacionit të bërë publik nga SPAK.

Publikimi i plotë i emrave, pavarësisht

se njoftimi për shtyp i SPAK përmban vetëm inicialet, lidhet me interesin e lartë publik që paraqesin çështjet e korrupsionit, ku përfshihen zyrtarë të dyshuar për shpërdorim detyre apo/ose abuzim me fondet publike. Ky publikim plotëson nga njëra anë pritshmëritë legjitime të publikut për informacion të plotë dhe të verifikueshëm, dhe nga ana tjetër, pritshmëritë e vetë mediave për informacione që eventualisht mund të ndihmojnë në zbardhjen e mëtejshme të çështjes.

Nga shqyrtimi i përmbajtjeve nuk rezulton të ketë pasur ndërhyrje në aspekte private që tejkalojnë qëllimin e raportimit, dhe nuk janë përdorur elementë spekulativë apo diskreditues përtej të dhënave të referuara nga autoriteti zyrtar. Mediat janë kufizuar në përdorimin e termit "të dyshuar", në

përputhje me detyrimet e përcaktuara në Kodin e Transmetimit.

Në përputhje me nenet 2.5 dhe 2.11 të Kodit të Transmetimit, përmbajtja e publikuar vlerësohet si e justifikuar nga interesi publik për informim lidhur me një çështje që përfshin keqpërdorimin e detyrës dhe abuzimin me fondet publike. Sa i përket shqetësimit për cenim të figurës suaj profesionale, nga përmbajtjet e analizuar rezultojnë se referimi është bërë ndaj funksionit tuaj administrativ në një institucion publik, sipas të dhënave të konfirmuara në njoftimin zyrtar të SPAK.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave nuk konstaton shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
I.K.	TV Klan News24	Edicioni i lajmeve	20.08.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit I.K me objekt *"publikimin e informacioneve të pavërteta në adresë të personit Tuaj në edicionet e lajmeve të televizioneve Klan TV dhe News 24.*

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit I.K lidhur me *"publikimin e informacioneve të pavërteta në adresë të personit Tuaj në edicionet e lajmeve të televizioneve Klan TV dhe News 24.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga verifikimi i përmbajtjeve audiovizive, kryer nga Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, rezultoi se lajmet e publikuara në edicionet informative të subjekteve të sipërpërmendura, referoheshin plotësisht në njoftimin

dhe pamjet filmike zyrtare, të shpërndara nga Policia e Shtetit, përmes publikimit në faqen e saj zyrtare, pa kryer modifikime, shtesa apo interpretime që do të përbënin ndryshim të përmbajtjes zyrtare. Për rrjedhojë, lajmi i publikuar nga mediat është një pasqyrim i informacionit të bërë publik nga një organ shtetëror kompetent, i cili, sipas praktikës së konsoliduar gazetareske, konsiderohet burim i besueshëm dhe i verifikuar. Në këtë kuptim, Klan TV dhe News 24 rezultuan në përputhje me detyrimet ligjore dhe me parimet profesionale të raportimit mbi çështje me interes publik, duke ushtruar funksionin e tyre si përcjellës të informacionit zyrtar. Referuar neneve përkatëse të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe dispozitave të Kodit të Transmetimit, nuk konstatohet shkelje e operatorëve lidhur me përmbajtjen e transmetuar në këtë rast. Duke qenë, se raportimi është bërë në përputhje me burimet zyrtare dhe pa cenuar dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shërbimeve mediatike audiovizive, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive nuk gjeti bazë ligjore për vijim procedurash.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.A.	TV Klan	E diela shqiptare	08.09.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasës E.A me objekt *"dëm moral, reputacional, psikologjik dhe familjar."*

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit E.A ku ankuesi pretendonte se *"Televizioni KLAN në emisionin E Diela Shqiptare / Shihemi në Gjyq, e cila do të transmetohet në ditët në vazhdim... do të bëhen publike, pa pëlqimin tim informacione që lidhen me jetën time private, duke më ekspozuar në publik dhe duke më shkaktuar dëm moral, reputacional, psikologjik dhe familjar."*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave e informoi ankuesin se për mos transmetimin/ndalimin e emisionit *"Shihemi në gjyq"* është

jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar Ligjit nr. 97/2013, *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, konkretisht neni 2, *"Fusha e zbatimit"*, sanksionon se *"Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove..."* .

Ankuesit iu bë me dije se aspekti i *"urdhërojë ndalimin/heqjen e materialit nga çdo platformë ku është publikuar"* është jashtë kompetencave ligjore të AMA-s dhe nuk është objekt trajtimi prej tij. Neni 53 *"E drejta e përgjigjes"*, pika 4-5, përcakton se *"Personi që ushtron të drejtën e përgjigjes, në përputhje me rregulloren, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar ofruesit përgjegjës të shërbimit mediatik, duke paraqitur arsyet dhe faktet që mbështetin kërkesën e tij kërkesë me shkrim, drejtuar ofruesit përgjegjës të shërbimit mediatik, duke paraqitur arsyet dhe faktet që mbështetin kërkesën e tij. Kërkesa për të drejtën e përgjigjes duhet të paraqitet tek OSHMA-ja brenda 10 ditëve nga*

transmetimi, të cilit i adresohet kjo kërkesë". Më tej, OSHMA-ja, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes dhe për këtë njofton me shkrim kërkuesin. Nëse brenda afatit të përcaktuar në pikën 6 të këtij neni kërkuesi nuk merr një përgjigje, prezumohet se OSHMA-ja ka refuzuar kërkesën. Sipas së njëjtës dispozitë

ligjore, Këshilli i Ankesave, brenda 15 ditëve nga paraqitja e një ankese për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga një OSHMA, shqyrton çështjen dhe, nëse e gjen të drejtë ankesën e bërë, i kërkon OSHMA-së korrigjimin e fakteve dhe informacioneve, në lidhje me personin e interesuar, në një mënyrë të ngjashme dhe kohë të njëjtë me atë të transmetimit objekt ankese, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.N.	Ora News	Dnight	03.10.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrtoi ankesën e shtetasit B.N me objekt "shkelje të kodit të etikës nga emisioni Dnight, transmetuar në televizionin Ora News".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit I.D ku ankuesi pretendonte se ishte shkelur kodi i etikës nga emisioni "Dnight", transmetuar në televizionin "Ora News".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit nuk rezultoi të kishte shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat

audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 60, datë 10.07.2023. Edhe në rastet kur të intervistuarit përmendnin elementë si bixhozi, droga apo alkooli, moderatorja e emisionit ndërhynte, duke i ndaluar diskutimet dhe duke këshilluar shmangien e konsumit të tyre.

Sakaq, u konstatua se programi transmetohej në fashën orare të mbrëmjes së vonë (ora 23:00), kur Kodi i Transmetimit parashikon një regjim më të lirë editorial, duke qenë se këto orare konsiderohen jashtë fashave kohore ku programet mund të ndiqen gjerësisht nga fëmijët dhe të miturit. Kjo natyrë e programeve të vona ("late night shoës") karakterizohet nga një stil më i lirë i të shprehurit, me trajtim të temave të larmishme, por gjithsesi brenda kufijve të përcaktuar nga kuadri ligjor dhe etik.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Ankues	MCN TV	Të pa ekspozuarit	06.10.2025

1. 1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë me objekt program televiziv me *"shprehje fyese dhe diskriminuese ndaj presidentit të Republikës së Shqipërisë, z.Bajram Begaj"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën përmes së cilës pretendohet se në emisionin "Të pa ekspozuarit", transmetuar në televizionin "MCNTV" në datën 2 Tetor 2025, ka patur

shprehje fyese dhe diskriminuese ndaj presidentit të Republikës së Shqipërisë, z.Bajram Begaj.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, propozon: - vendosjen e sanksionit gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë ndaj subjektit audioviziv "MCNTV", - ndalimin e ritransmetimit të sekuencave përkatëse të emisionit "Të paekspozuarit" të datës 2 Tetor 2025, si dhe - detyrimin e operatorit për heqjen e sekuencave përkatëse nga kanali i tij zyrtar në YouTube.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Ankues	Syri TV	Emisioni mëngjesit	08.10.2025

1. Objekti i Ankesës

Ankues iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive objekt emisionin mëngjesit në "Syri TV". Ankuesi pretendonte se qytetarët kishin shprehur deklarata që nxisin intolerancë, dhunë deri edhe tek të nxitja e veprave penale apo cenimin e autoritetit të shtetit. Sipas ankuesve, deklaratat e qytetarëve kishin kaluar pa reagim nga ana e gazetarëve në studio".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën përmes së cilës pretendohet se në emisionin "Kafe shqeto", transmetuar në Syri TV, në datën 07.10.2025 në orën 07:00:00-09:00:00 ku qytetarët kishin shprehur deklarata që nxisin intolerancë, dhunë deri edhe tek të nxitja e veprave penale apo cenimin e autoritetit të shtetit

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga këqyerja e përmbajtjes audiovizive, KA vlerësoi se krijimi i hapësirave për qëndrime të tilla jotolerante nuk lidhet me pluralitetin dhe lirinë e fjalës, pasi ato promovonin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë akte dhune, duke mos respektuar kërkesat ligjore në fuqi. Referuar ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 4, pika 2/"d" dhe "dh" përcaktohet se operatorët e shërbimit audioviziv, "gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve", si dhe "udhëhiqen nga moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën".

Po aty, në nenin 33, pika 1/"d" thuhet se: "Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale".

Edhe në Kodin e Transmetimit, thuhet qartë se në transmetimet audio dhe

audiovizive "nuk duhet të përdoren shprehje, që përmbajnë gjuhë urretje, denigrim ose stigmatizim kundër një personi ose grupi personash, nuk duhet të përdoret gjuhë që promovon, nxit ose justifikon dhunën ndërmjet shtetasve në përgjithësi...", pika 1.6, si dhe OSHMA-të, "në programet informative, nuk promovojnë për qëllime sensacionale, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhunën, nuk transmetojnë pamje, thirrje për urretje apo mesazhe ekstremiste, nuk përdorin gjuhë sensacionale, provokuese ose stigmatizuese", pika 3.9.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave, bazuar në "Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i

Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes", e ndryshuar me vendimin e AMA-s, nr.56, datë 07.07.2023, neni 6 "Konkluzionet e Këshillit të Ankesave", pika 4, ju tërheq vëmendjen për shmangie nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nga Kodi i Transmetimit (miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, i amenduar me vendimin nr.107, datë 11.11.2024), dhe i kërkoi ndalimin e ritransmetimit të përmbajtjeve audiovizive të sipërpërmendura si dhe heqjen e menjëhershme të këtyre përmbajtjeve nga kanali juaj zyrtar në YouTube si edhe faqja juaj zyrtare në internet.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.G.	TV Klan	Stop	08.10.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit M.G me objekt *"verifikim për fushatë denigruese dhe dëm ekonomik ndaj "NRG"sh.p.k., si dhe konkurrencë të pandershme nga "AIR" sh.p.k."*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit M.G i cili pretendon se *"në emisionin "Stop", transmetuar në "TV Klan" në datën 10.09.2025, ora 20:00, është publikuar një material audioviziv, duke keqinformuar publikisht, në cenim të reputacionit tregtar ndaj shoqërisë "NRG" sh.p.k mbi bazën e informacioneve të pavërteta, të*

njëanshme dhe të motivuara nga interesa konkurrionale. Gjithashtu, shtetasi M.G pretendon se gazetarët e emisionit "Stop" nuk kanë kontaktuar në asnjë moment për të kërkuar shpjegime apo qëndrim zyrtar mbi çështjet e trajtuara në kronikë".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke mirëkuptuar shqetësimin për të cilën keni bërë kërkesë, ju bëjmë me dije sa më poshtë vijon: Në kuadrin e administrimit të pretendimeve Tuaja, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrtoi përmbajtjen audiovizive, konkretisht emisionin "Stop", transmetuar në TV Klan në datën 10.09.2025, (minutazhi 20:43:00-20:56:00).

Në emision, trajtohet shitja e pesticideve në Shqipëri, duke përmendur shoqërinë "NRG" sh.p.k. Si palë e trajtuar në emision, mungonjë deklaratat. Ndaj dhe në përputhje me kërkesat e ligjit, nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht, Neni 53 "E drejta e përgjigjes", parashikon të drejtën e përgjigjes brenda 10 ditëve nga transmetimi.

Dispozitë ligjore që ngarkon OSHMA-në me përgjegjësi për t'ju dhënë hapsirë për të ushtruar të drejtën e përgjigjes apo ajo që kërkon ju, "përgënjeshttrim dhe saktësimin e informacionit" si dhe "transmetimin e përgënjeshttrimit zyrtar të shoqërisë sonë në një moment

të barabartë dhe me të njëjtën dukshmëri”.

Sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive iu drejtua OSHMA-së, TV Klan, të përmbushë detyrimin ligjor, për ushtrimin nga ana juaj të “Të drejtën e përgjigjes”, konform ligjit nr.972013.

Nga OSHMA-ja “TV Klan” u informuam se: “emisioni “Stop” në Rtv Klan, lidhur me rastin e transmetuar për Kompaninë NRG, iu drejtua edhe këtij subjekti, konform rregullave, parimeve të gazetarisë dhe afateve të parashikuara, që ky subjekt, të jepte versionin e tij, për gjetjet e përmendura në program. Gazetari i emisionit “Stop” u takua me dy aksionerët Kompanisë NRG, Flutura Nuredini dhe Marco Geniço, por ata nuk e panë të arsyeshme, të flasin para kameras. Përsa më sipër disponojmë edhe pamje

filmike të takimit dhe refuzimit të tyre, për të folur”.

Për rrjedhojë, konstatojmë, në zbatim të dispozitës ligjore nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, OSHMA-ja, TV Klan ju ka ofruar të “Drejtën e përgjigjes”, gjë të cilën, sipas pretendimeve të OSHMA-së është refuzuar prej jush.

Ndaj, dhe AMA, në cilësinë e tij si autoritet i pavarur rregullator, në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë konsideron të administruar ankesën tuaj.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
I.B.	Syri TV	Piranjat	10.10.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit D.B me objekt *"përmbajtjen e emisionit "Piranja" në televizionin Syri TV, transmetuar më datë 03.10.2025.*

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit D.B i cili pretendon *"se gazetarët e emisionit ju kanë filmuar fshehurazi në zyrë, pa dijeninë dhe pa pëlqimin tuaj, dhe se materiali i përftuar është përdorur më pas për shpifje dhe denigrim profesional. Ju kërkoni"*

Hetimin e plotë të rastit;

Ndalimin e menjëhershëm të transmetimit të materialit;

Marrjen e masave administrative ndaj emisionit dhe personave përgjegjës për shkelje të privatësisë dhe shpifje.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga verifikimet e kryera: Nuk rezulton shkelje e privatësisë, pasi gjatë materialit të transmetuar ju vetë deklaroni se ofroni një shërbim fetar, i cili ka karakter publik dhe si i tillë nuk ndalohej t'i paraqitet publikut nëpërmjet mediave audiovizive.

Pretendimi për denigrim profesional apo dëmtim të reputacionit nuk u konstatua, pasi gjatë programit gazetarët ju kanë dhënë mundësinë të shprehni publikisht qëndrimet dhe aftësitë tuaja profesionale.

Po ashtu, nuk u konstatua keqpërdorim i imazhit për qëllime sensacionale mediatike, pasi përmbajtja e programit është realizuar në përputhje me rregullat e etikës profesionale dhe pa përdorur elemente nënçmuese apo deformuese të figurës suaj.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.L.	Syri TV	Kafe Shqeto	21.10.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit E.L me objekt *"emisionin "Kafe shqeto", transmetuar në Syri TV në 10. 10.2025 në orën 07:00- 10:00"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit E.L i cili pretendon: *"Se i ftuarit A.M ka përdorur gjuhë urrejtje dhe nxitëse, duke përmendur emrin e prokurores dhe duke vlerësuar vrasësin e gjyqtarit, deklarata të cilat ju pretendoni se moderatori nuk ka ndërhyrë"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave, bazuar në "Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes", e ndryshuar me vendimin e AMA-s, nr.56, datë 07.07.2023, neni 6 "Konkluzionet e Këshillit të Ankesave", pika 4,

I tërhoqi vëmendjen OSHMA-së për shmangie nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nga Kodi i Transmetimit (miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, i amenduar me vendimin nr.107, datë 11.11.2024), dhe kërkoi: ndalimin e ritransmetimit të përmbajtjeve audiovizive të sipërpërmendura.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.L.	Klan TV	Stop	22.10.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetases L.L me objekt: *"Një material të publikuar në emisionin "Stop", të transmetuar më datë 07.10.2025 në televizionin TV Klan"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases L.L e cili pretendon: *"Se gjatë këtij transmetimi:u publikuan të dhënat e saj personale pa pëlqimin e saj;u cënuar imazhi dhe dinjiteti i saj në komunitetin ku jeton;u përdorën shprehje denigruese, që dëmtojnë jo vetëm reputacionin e saj, por edhe perceptimin publik së fëmijës së përfshirë në rast"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim të shqyrtimit, bazuar në gjetjet e mësipërme dhe në zbatim të

Rregullores mbi procedurat e shqyrtimit të ankesave dhe të drejtës së përgjigjes (neni 8), Këshilli i Ankesave vendos të tërheqë vëmendjen e subjektit "TV KLAN" për shkeljet e konstatuara dhe i kërkon: të heqë menjëherë sekuencat përkatëse nga faqet zyrtare dhe platformat e shpërndarjes së videove; të mos i ritransmetojë ato në asnjë formë; të raportojë zbatimin e vendimit brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

Në vijim, ju bëjmë me dije se: Bazuar në "Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes", e ndryshuar me vendimin e AMA-s (nr.60, datë 10.07.2023, i amenduar me vendimin nr.107, datë 11.11.2024): "Mosndreqja e shmangies nga kërkesa ligjore përkatëse brenda një afati 30-ditor çon automatikisht në marrjen e masave sipas nenit 133 të ligjit nr.97/2013, të ndryshuar" (neni 6, pika 4/a); "Më shumë se tri shmangie me të njëjtin objekt brenda të njëjtit vit kalendarik çojnë automatikisht në marrjen e masave sipas nenit 133 të ligjit nr.97/2013, të ndryshuar" (neni 6, pika 4/b).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim	A2CNN	Off record	11.11.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e Qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim me objekt: *deklarata mizogjene, seksiste, homofobike dhe fyese ndaj znj.M. A dhe z.A.H.*

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e Qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim, ku u evidentua se në emisionin "Off record", transmetuar në A2CNN në Dt. 28 Tetor 2025 "Diskutimi degradon në ofendime personale, ndërprerje dhe gjuhë denigruese, duke u shndërruar nga debat televiziv në përplasje verbale mes pjesëmarrësve. Moderatorin ndërhyr vetëm një herë, gjithë debatit nuk arriti të mbante rendin".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave konstatoi se komunikimi i mësipërm shkel Ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60 datë 10.07.2023 (amenduar me vendimin nr.107, datë 11.11.2024)

Këshilli i Ankesave, propozon: vendosjen e sanksionit gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë ndaj subjektit audioviziv "A2CNN", ndalimin e ritransmetimit të sekuencave përkatëse të emisionit "Off record" të datës 28 Tetor 2025, si dhe detyrimin e operatorit për heqjen e sekuencave përkatëse nga kanali i tij zyrtar në YouTube.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.M.	RTSH	-	11.11.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit

A.M me objekt: *objekt: "publikimin e një materiali nga Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), ku është shfaqur fytyra e familjarit të tij, aktualisht i dyshuar në një çështje që ndodhet ende në fazë hetimore, e shoqëruar me përshkrimin 'autori i dyshuar për përdhunim'."*

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit A.M i cili ankohej se *në një nga emisionet e RTSH "u publikua e një materiali ku është shfaqur fytyra e familjarit të tij, aktualisht i dyshuar*

në një çështje që ndodhet ende në fazë hetimore, e shoqëruar me përshkrimin 'autori i dyshuar për përdhunim'".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në ankesë pretendohet shkelja e Kodit të Etikës, konkretisht të neneve 4, 8 dhe 11, të cilat mbrojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, privatësinë dhe dinjitetin e individit, si dhe ndalojnë publikimin e imazheve të personave të dyshuar në çështje të ndjeshme.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës u konstatua se informacioni i paraqitur nuk ishte i plotë. Për këtë arsye ju kërkua vënia në dispozicion e datës së saktë të transmetimit dhe emisionin ku ishte publikuar materiali, në mënyrë që të mund të kryejmë verifikimin ligjor dhe procedural të kërkuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.M.	NEWS 24	Me zemër të hapur	12.11.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit K.M me objekt: *"Ankesë për shpifje dhe shkelje të etikës profesionale nga televizioni 'News 24', emisioni 'Me Zemër të Hapur'"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit K.M i cili pretendon se *gjatë transmetimit të emisionit "Me Zemër të Hapur" në televizionin "News 24", më datë 25 prill 2025, janë bërë deklarata të pavërteta dhe denigruese ndaj tij. Për rrjedhojë, kërkoni nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) që të hetojë rastin dhe të verifikojë shkeljen e standardeve etike dhe ligjore nga televizioni "News 24".*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Lidhur me shqyrtimin e ankesës, Këshilli i Ankesave ju bën me dije se ankesa

juaj, me objekt emisionin "Me Zemër të Hapur", transmetuar në televizionin "News 24" në datën 25.04.2025, është paraqitur jashtë afatit të parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi.

Sipas nenit 52, pika 1, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet se: "Ankesa duhet të paraqitet me shkrim në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose, në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë."

Në këtë rast, duke qenë se kanë kaluar më shumë se 30 ditë nga data e transmetimit të përmbajtjes objekt ankese, Këshilli i Ankesave proceduralisht nuk mund të ndër marrë trajtimin e saj, pasi kjo do të përbente tejkalim të kompetencave ligjore të përcaktuara qartë në dispozitat e mësipërme.

Përtej rastit konkret, duke ju falënderuar për besimin në institucionet rregullatore, ju bëjmë me dije se Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive do të vazhdojë, si deri

tani, të trajtojë me seriozitet të gjitha ankesat dhe shqetësimet që lidhen me shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 60, datë 10.07.2023, i amenduar

me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024, si edhe të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive për rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe për sanksionet ligjore që burojnë nga shkelja e tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S.V.	RTSH	Super Gol	26.11.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetases

S.V me objekt: *"Emisionin "Super Gol – Prag ndeshje/Bylis – Flamurtari", transmetuar në "RTSH Sport".*

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases S.V dhe nisi verifikimet lidhur me pasqyrimin mediatik të ngjarjes nga OSHMA-ja. Në kuadrin e administrimit të pretendimeve Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjen audiovizive, emisionin "Super Gol" në kanalën RTSH Sport, transmetuar më datë 7 nëntor 2025.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në:

- Neni 4, pika 1/b, pika 2/dh,
- Neni 32, pika 4,
- Neni 33, pika 1/ç dhe pika 1/d, si dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 60, datë 10.07.2023, (i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024), konkretisht:
- Seksioni 1, pika 1.6,

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave i propozoi Bordit të AMA-s, vendosjen e sanksionit financiar ndaj subjektit audioviziv "RTSH". Propozimi u miratua nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive me "Vendim Nr.100, datë 17.11.2025".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.R.	Vizion Plus	Podkastro	16.12.2025

1. Objekti i Ankesës

G.R iu drejtua Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me objekt, transmetim "Përmbajtje antishqiptare në ekranin e Vizion Plus".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit G.Rr i cili ankohej se: "Gjatë emisionit Podkastro në Vizion Plus "është promovuar një personazh që, sipas ankuesit, shpif dhe përbalt një personalitet të rëndësishëm të kombit shqiptar".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive të emisionit "Podkastro", transmetuar në Vizion Plus më datë 5 dhjetor 2025, Këshilli i Ankesave evidentoi, se: "E ftuara në studio shprehte perceptime personale mbi mënyrën se si tema ishte trajtuar nga mësues dhe pedagogë gjatë viteve të saj të studimeve. Në asnjë moment të transmetimit nuk ishte

cenuar figura e heroit tonë kombëtar dhe diskutimi në studio ishte zhvilluar duke respektuar etikën e komunikimit në transmetim televiziv. Moderatorin dhe bashkëbiseduesin kishin mbajtur qëndrim korrekt dhe gjatë zhvillimit të bisedës nuk ishte konstatuar teprime apo komente denigruese në lidhje me figurën e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Për rrjedhojë, përmbajtja e trajtuar në këtë emision përfshihet në ushtrimin e lirisë së shprehjes, e cila është e garantuar nga Kushtetuta dhe nga kuadri rregullator në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuptim, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në zbatim të nenit 18 "Objektivat e veprimtarisë së AMA-s", ka për detyrë të sigurojë, ndër të tjera, "ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias".

Si përfundim, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në cilësinë e tij si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive, nuk konstatoi shmangie nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nga Kodi i Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2024.

2

Ankesa me objekt

"cenimin e të drejtave

të fëmijëve"

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.B.	Media	-	02.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrtoi ankesën e znj.A.B nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës e cila kishte konstatuar që në mënyrë të përsëritur në disa transmetime televizive kishte shkelje të dispozitave ligjore lidhur me rastin e abuzimit të një fëmije në Fier.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës se znj A.B lidhur me "*raportimin mediatik për abuzimin e dyshuar seksual të një të miture në Fier*", Këshilli i Ankesave kreu verifikimet lidhur me pasqyrimin e përgjithshëm mediatik të ngjarjes nga OSHMA-të.

Në kuadrin e administrimit të pretendimeve të znj A.B, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjet audiovizive, nga edicionet informative e deri tek emisionet e transmetuara prej OSHMA-ve në datat 1&2 Korrik 2025, nga ku evidentoi shmangie prej:

- Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në: nenin 4, pika 1/b; neni 46, pika 2/ç) dhe
- Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në: seksionin 1, pika 1.4 dhe seksionin 4, pika 4.24.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Konkretisht u monitoruan 16 OSHMA, prej të cilave u konstatua se ndonëse standardi i pasqyrimin të saj në mediat audiovizive ishte karakterizuar përgjithësisht nga profesionalizmi dhe kujdesi për mbrojtjen e viktimës, nga subjekti në subjekt, mënyrat konkrete të trajtimit mund të klasifikohen si: tërësisht korrekte, pjesërisht korrekte ose në shmangie të parimeve etike, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.

Mbulimi tërësisht korrekt, (4 raste) u karakterizua nga mbrojtja strikte e të dhënave personale të të miturës, shmangia e të dhënave rrethore, që mund të çonin në identifikimin e

saj të tërthortë si edhe nga qasja e kujdesshme, informuese larg sensacionit. Në trajtimet pjesërisht korrekte (3 raste), ndonëse u shmang publikimi i gjeneraliteteve të viktimës dhe u përdor teknikë mbulimi në intervista, u publikuan pamjet e shtëpisë dhe të dhëna rreth vendbanimit, duke mundësuar identifikimin e tërthortë të së miturës.

Shkeljet më flagrante të etikës (9 raste) – konstatuar si në informimin e drejtpërdrejtë gjatë edicioneve të lajmeve, ashtu edhe në emisionet pasuese – lidheshin me publikimin e gjeneraliteteve të të akuzuarit dhe nënës së viktimës së dyshuar, elementëve të panevojshëm identifikues të dëshmitë, pamjeve të shtëpisë (jashtë) dhe banesës (brenda) së viktimës, me intervistimin e nënës së saj, në kushte emocionale të rënduara dhe publikimin e saj pa teknikë mbulimi.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive i tërhoqi vëmendjen (në 9 raste) për shkeljet e dispozitave të mësipërme, kërkoi ndalimin e çdo ritransmetimi të materialeve në fjalë si edhe fshirjen e tyre nga llogaritë përkatëse në YouTube dhe çdo prani tjetër online, duke rikujtuar se përsëritja e shkeljeve penalizohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Për trajtimet pjesërisht korrekte (3 raste), Autoriteti u solli në vëmendje OSHMA-ve, se përpjekjeve për respektimin e

standardeve etike të transmetimit u kishte shpëtuar publikimi i të dhënave rrethanore, që gjithashtu çon në identifikimin e tërthortë të viktimës.

Paralelisht komunikimit administrative me OSHMA-të, nisur nga fakti, se si burim i parë i të dhënave rrethanore dhe shoqërore, që zbulonin identitetin e të prekurve të abuzimit e dyshuar seksual të një të miture brenda familjes, shërbeu njoftimi i Policisë së Shtetit, në kuadrin e "*Sistemit të integruar të mbrojtjes*" dhe "*Interesit më të lartë të fëmijës*" që sugjeron ligji "*Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës*", kreu i Autoritetit të Mediave Audiovizive ju drejtua edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për t'i sjellë në vëmendje detyrimin mbarëshoqëror "*për të mbrojtur në të gjitha situatat privatësinë e fëmijës*".

- Ligjit nr.97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar (neni 4, pika 2/dh dhe neni 46, pika 2/c) dhe
- Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023 i amenduar me vendimin nr.107, datë 11.11.2024 (Seksioni 3, pika 3.9 dhe Seksioni 5, pika 5.31).

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur, i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së për mënyrën e trajtimit të çështjes.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.M.	News 24	"Me zemër të hapur"	11.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim kërkesën e znj. E. M me objekt emisionin "Me zemër të hapur", transmetuar në News 24.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e znj. E. M me pretendimin se: *"Gjatë emisionit, pa dijeninë të ankueses dhe pa vendosur filtra janë transmetuar foto dhe video personale dhe të fëmijëve bashkë me emrat"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrtoi

përmbajtjen audiovizive dhe vlerësoi se përmbajtja e transmetuar përbënte shmangie nga dispozitat e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht:

- Neni 4, pika 2/dh:
- Neni 46, pika 2/c: "pika 2/dh:

Kodi i Transmetimit i miratuar me vendimin nr. 60, datë 10.07.2023, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024:

- Seksioni 3, pika 3.9:
- Seksioni 5, pika 5.31:

Pamjet filmike të transmetuara ishin pjesë e një procesi gjyqësor të trajtuar më parë nga organet ligjzbatuese. Transmetimi në formën aktuale synon efekte sensacionale dhe përbën shkelje të qartë të dispozitave ligjore dhe rregullatore.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
ASHDMF	"A2 CNN" "ABC News" "Euro Balkans News" "Vizion Plus" "Top Channel" "Drita TV" "TV 4+"	Kronikë	02.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nisi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive. Agjencia ankohej për publikim në mënyrë të përsëritur, në disa transmetime televizive identitetin dhe detaje të ndjeshme që cenonin rëndë privatësinë dhe dinjitetin e fëmijëve, rasti lidhej me abuzimin e një fëmije në Patos/Fier.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e ASHDMF-së dhe nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive, konstatoi shmangie nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe kërkoi ndalimin e ritransmetimit të përmbajtjeve audiovizive të sipërpërmendura; heqjen e tyre nga kanali juaj zyrtar në YouTube, brenda një afati prej 30 ditësh.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.G.	DigitAlb	Çufo TV	13.08.2025

1. 1.Objekti i Ankesës

A.G i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, film vizatimor të transmetuar në një kanal televiziv për fëmijë, konkretisht në stacionin Çufo TV të platformës me pagesë Digitalb.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit A.G lidhur me një përmbajtje të transmetuar në një kanal televiziv për fëmijë, konkretisht në stacionin Çufo TV të platformës me pagesë Digitalb.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përputhje me ligjin organik, AMA ushtron funksionet e saj mbikëqyrëse në bazë të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke u fokusuar në përputhshmërinë e përmbajtjeve me normat ligjore dhe etike, sidomos kur

bëhet fjalë për mbrojtjen e të miturve. Megjithatë, Autoriteti nuk ndërhyr në përzgjedhjet editoriale të subjekteve mediatike, përfshirë programacionin dhe temat që ato zgjedhin të trajtojnë, përveç rasteve kur përmbajtjet përbëjnë shkelje të qarta të dispozitave ligjore mbi mbrojtjen e fëmijëve (p.sh., dhunë e panevojshme, gjuhë urrejtjeje, skena të rënda që cenojnë integritetin fizik ose moral të të miturve).

Seriali në fjalë lidhej me një prodhim ndërkombëtar, i transmetuar në shumë vende dhe i klasifikuar si program për fëmijë nga vetë prodhuesit dhe shpërndarësit ndërkombëtarë. Përfshirja e personazheve që përfaqësojnë modele të ndryshme familjare, përfshirë familjet LGBTQ+, nuk konsiderohet shkelje ligjore apo etike sipas standardeve aktuale rregullatore, të cilat respektojnë parimin e lirisë së shprehjes dhe të mosdiskriminimit, të garantuar nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në raste të tilla, ku bëhet fjalë për përmbajtje që nuk përfshin skena të papërshtatshme për moshën e mitur, por që mund të perceptohet ndryshe

në varësi të bindjeve personale, vendimmarrja për ndjekjen ose jo të programit mbetet ekskluzivisht zgjedhje e prindërve. Ligji nuk parashikon kufizime për përfshirjen e personazheve me orientime apo modele të ndryshme familjare në programet për fëmijë, për sa kohë ato

nuk përmbajnë elementë drejtpërdrejt të dëmshëm për zhvillimin e tyre psikofizik.

Duke u bazuar në sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk konstatoi shkelje të dispozitave ligjore nga ana e subjektit audioviziv, për sa i përket transmetimit të serialit të përmendur.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
V.A.	News 24	Me zemër të hapur	04.12.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasës

V.A me objekt: *"Emisionin "Me zemër të hapur", transmetuar më datë 11.11.2025 në televizionin "News 24".*

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasës V.A e cila pretendonte se gjatë këtij transmetimi:

- *u publikuan emri dhe të dhënat e fëmijës,*
- *u dhanë deklaratat publike që nxisin kontakt me babain, pavarësisht se ky i fundit është i dënuar për keqtrajtim ndaj të miturit dhe ndaj tij është hequr e drejta prindërore,*
- *u bë thirrje publike nga drejtuesja e emisionit që "babai të takojë fëmijën", duke ndikuar negativisht në*

gjendjen emocionale të fëmijës, duke shkelur vendimet gjyqësore në fuqi.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave konstatoi, se përtej pretendimeve të ankueses, në emisionin "Me zemër të hapur":

- *nuk ishte respektuar interesi më i lartë i fëmijës dhe detyrimi për të mbrojtur identitetin dhe dinjitetin e tij;*
- *fëmija, ndonëse jo i pranishëm është krejtësisht i identifikueshëm për shkak të ekspozimit të të dhënave rrethore (identiteti i prindërve dhe familjarëve);*
- *ishin përdorur detaje nga dosje hetimore, që dëmtojnë rehabilitimin e tij dhe imazhin e fëmijës së prekur.*

Për rrjedhojë, përmbajtja audiovizive e sipërpërmendur paraqet shmangie nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, Këshilli i Ankesave ju tërheq vëmendjen për shmangiet.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.GJ.	Top Channel	Fiks Fare	09.12.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë nga shtetasi L. Gj me objekt: *"emisionin Fiks Fare"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases L.Gj e cila pretendonte se *"është publikuar imazhi i fëmijës, për të cilën pretendon se nuk ka dhënë leje për publikim. Ky material, pretendon ankuesja, ka sjellë gjendje të rënduar psikologjike dhe fëmija nuk shkon as në shkollë"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga këqyerja e materialit filmik, rezultoi intervistomi me zë dhe me figurë (*gjeneralitete të plota*), të prindit denoncues, znj.L.Gj, dhe publikimin (*ndonëse me blur*) të denoncimit të fëmijës lidhur me ngacmimet dhe dhunën që ushtrojnë shokët e klasës

ndaj tij.

Publikimi me fytyrë i prindit, identifikon indirekt edhe fëmijën, teksa dëshmia e tij edhe pse është përdorur teknologjia e mbulimit, në fakt vijon të dëmtojë interesin më të lartë të fëmijës për të cilën flitet në këtë emision dhe ndikon negativisht edhe te perceptimi i fëmijëve, që gjithashtu mund të jenë në situata të tilla.

Këtu është vendi, të theksohet gjithashtu se, ndjeshmëria e veçantë e AMA-s ndaj punës së gazetarëve në formatet investigative, si mbartës të lirisë së shprehjes dhe përfaqësues të interesit publik, nuk mund të kuptohet si justifikim i shkeljes së normave profesionale dhe ligjore që rregullojnë transmetimet audiovizive, veçanërisht kur bëhet fjalë për fëmijë, të cilët gëzojnë mbrojtje të posaçme sipas ligjit dhe Kodit të Transmetimit.

Për rrjedhojë, përmbajtja audiovizive e sipërpërmendur paraqet shmangie nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, konkretisht:

- Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4, pika

1/b:

b) veprimtaria e transmetimeve audiovizive ... respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e fëmijëve;

- Kodi i Transmetimit Audioviziv, Seksioni 2, pika 2.2, 2.12 dhe Seksioni 4, pika 4.1 dhe 4.4:

"Transmetimet audio dhe audiovizive për fëmijët udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës. Interesi më i lartë i fëmijës është parësor në çdo veprim të OSHMA-ve që përfshin fëmijën apo i drejtohet fëmijës."

"OSHMA-të garantojnë respektimin e jetës private, familjare, banesës, korrespondencës së fëmijës. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, me përjashtim të rasteve kur interesi më i lartë i fëmijës dikton diçka tjetër. Privatësia e fëmijës, që merr

pjesë në procedurat gjyqësore ose administrative mbrohet në pasqyrimin audioviziv të këtyre procedurave, me përjashtim të rasteve kur interesi më i lartë i fëmijës dikton diçka tjetër dhe në atë masë, që i shërben këtij interesi."

Nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave ju Tërheq Vëmendjen për shmangiet dhe njëkohësisht kërkon:

- heqjen e sekuencës së sipërpërmendur (imazhi i fëmijës), dhe aplikimin e teknikave të mbulimit të identitetit të familjarëve në mbrojtje të të dhënave personale të fëmijës;
- bllokimin e ritransmetimit të materialit pa reflektimin e masave të sipërpërmendura;
- raportimin e zbatimit të këtyre masave brenda një afati ligjor prej 30 ditësh dhe njoftimin e Autoritetit masat e marra.

3

Ankesa jashtë

juridiksionit

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.G.	-	-	09.07.2025

1. Objekti i Ankesës

R.G i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me kërkesën për parandalimin e publikimit të të dhënave personale në media.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të pretendimeve Tuaja, ju informojmë se, AMA, në cilësinë e tij si autoritet i pavarur rregullator, në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Sipas dispozitave të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 2 "Fusha e zbatimit", përcakton se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar". Pra, Autoriteti është përgjegjës për monitorimin e transmetimeve audiovizive lineare, transmetimeve audiovizive jolineare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove.

Për rrjedhojë, aspekti i "parandalimit të publikimit të të dhënave personale në mediat audiovizive" është jashtë kompetencave ligjore të AMA-s dhe nuk është objekt trajtimi prej tij.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.Gj.	YouTube	Odeta Dume	14.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrtoi ankesën e z. M.Gj me objekt publikimin në YouTube të një materiali pa pëlqimin e ankuesit.

2. Administrimi i Ankesës.

Gjatë administrimit të ankesës së M. Gj i cili pretendonte se *"në kanalën e gazetares Odeta Dume në YouTube është publikuar një material audioviziv, transmetimi i të cilit është bërë pa pëlqimin e ankueses dhe përmbajtja e të cilit konsiderohet nga ankuesi si të dëmshme"*. Për këtë arsye, kërkoi, që *"kjo video të hiqet nga platforma Youtube dhe të mos përsëritet më një rast i ngjashëm"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Referuar ligjit nr. 97/2013, *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, konkretisht nenit 2, *"Fusha e zbatimit", "Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive*

lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformave të shpërndarjes së videove".

Në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të platformës YouTube në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion mbi të.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
SH.N.	YouTube	-	18.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrtoi ankesën e shtetasit SH.N me objekt "një material të publikuar në platformën YouTube në vitin 2019".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të saj, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s evidentoi se SH.N kërkonte:

- *"Fshirjen e materialeve të publikuara në platformën "YouTube" apo çdo platforme tjetër ku janë publikuar materiale në emër të Perlat Myrtaj, lidhur me një ngjarje të vitit 2019.*
- *Vendimi ka marrë formë të prerë dhe kërkuesi P.M është shpallur i pafajshëm dhe të gjitha lajmet e*

botuara në media elektronike janë të pavërteta dhe si rezultat duhet të fshihen".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 2, "Fusha e zbatimit", "Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Mediat online dhe portalet janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Gjithashtu, në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të platformës You Tube në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion mbi të.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.D.	MCN TV	Xhadat	04.08.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit

F.D me objekt përmbajtjen e emisionit "Xhadat", transmetuar nga subjekti audioviziv "MCN TV" më datë 24.07.2025

2. 2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive ushtroi funksionet e tij në përputhje me Ligjin nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, referuar, (neni 2, pika 1) dhe (neni 18, pika 1/a,b), në këtë kuadër, Autoriteti nuk

ndërhyn dhe nuk mund të japë vlerësim mbi çështje që përfshijnë verifikime dokumentesh, konflikte pronësie, apo pretendime për mashtrim dhe shpifje, pasi këto janë kompetenca të sistemit gjyqësor dhe institucioneve të tjera publike.

Nga verifikimi i përmbajtjes audiovizive të emisionit "Xhadat", datë 24.07.2025, rezultonte se subjekti MCN TV ka ofruar të drejtën e përgjigjes, siç parashikohet në nenin 53 të Ligjit nr. 97/2013, por ju nuk e keni shfrytëzuar këtë të drejtë, pavarësisht disa përpjekjeve për komunikim nga redaksia e emisionit. Në këto kushte, AMA nuk konstaton shkelje të së drejtës së përgjigjes nga subjekti në fjalë dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron kërkesa për ndërhyrje administrative ndaj transmetuesit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
ASHDMF	Media dhe portale		08.08.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e ASHDMF me objekt publikimin e një lajmi nga media dhe portale të një fëmije 12 vjeçar.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave në AMA administroi ankesën e ASHDMF lidhur me pasqyrimin mediatik të rastit të një fëmije 12 vjeçar ku pretendohet se "imazhi i të cilit po keqpërdoret në lajmet e disa mediave dhe portaleve në Shqipëri...duke keqpërdorur imazhin

e fëmijës, bullizim, denigrim të tij dhe familjarëve".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Bazuar në Ligjin nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, konkretisht nenit 2, "Fusha e zbatimit", "*Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove*".

Mediat online dhe portalet mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
J.K	"Jeta Osht Qejf"	Foto	12.08.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e z.J.K me objekt publikimin e *"një foto nga portali "Jeta Osht Qejf"*. Ankuesi pretendonte se imazhi i publikuar ishte marrë pa leje, çka ka shkaktuar dëm psikologjik tek ai dhe familjarët e tij.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave në AMA administroi ankesën e shtetasit J.K lidhur me *"publikimin e një foto pa lejen e ankuesit në portalin "Jeta Osht Qejf"*, referuar ligjit nr. 97/2013, *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, konkretisht nenit 2, *"Fusha e zbatimit", "Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre"*, mediat online dhe portalet janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
XH.C	Tik Tok	-	18.08.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetases Xh.C me objekt *"publikimin e fotos dhe të dhënave personale në platformën Tik Tok duke e ngatërruar për një person tjetër"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases XH.C lidhur me publikimin e fotos dhe të dhënave të

saj personale në platformën Tik Tok duke e ngatërruar me një person tjetër.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankuesit iu bë me dije se në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 06.03.2025, i cili ndalon aksesin zyrtar në platformën TikTok në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka mundësi institucionale për të ndjekur apo raportuar përmbajtje të dëmshme në këtë platformë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.S	JOQ Albania	-	26.08.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetas

A.S me objekt *"një rast të përdorimit të paautorizuar të imazhit të saj nga JOQ Albania"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetas A.S lidhur me ankesën, mbërritur përmes postës elektronike (info@ama.gov.al), më datë 23.08.2025, *"në lidhje me një rast të përdorimit të paautorizuar të imazhit nga JOQ Albania ku pretendohet se "është marrë një intervistë/video ku nuk jeni informuar dhe nuk keni dhënë kurrë pëlqim, që të publikohet"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke mirëkuptuar shqetësimin dhe ndjeshmërinë tuaj, ju bëjmë me dije sa më poshtë: sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 2, "Fusha e zbatimit", ky ligj zbatohet për "transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Mediat online dhe portalet mbeten nuk bëjnë pjesë në të.

Edhe pas ndryshimeve të fundit, të miratuara me ligjin nr. 30/2023, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013", mediat online dhe portalet vijojnë të mos përfshihen në objektin e veprimtarisë së AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.S	JOQ Albania	-	26.08.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasës

A.S me objekt "*një rast të përdorimit të paautorizuar të imazhit të saj nga JOQ Albania*".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasës A.S lidhur me ankesën, mbërritur përmes postës elektronike (info@ama.gov.al), më datë

23.08.2025, "në lidhje me një rast të përdorimit të paautorizuar të imazhit nga JOQ Albania ku pretendohet se "është marrë një intervistë/video ku nuk jeni informuar dhe nuk keni dhënë kurrë pëlqim, që të publikohet". Bazuar në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 2, "Fusha e zbatimit", ky ligj zbatohet për "*transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre*". Mediat online dhe portalet mbeten nuk bëjnë pjesë në të, mediat online dhe portalet vijojnë të mos përfshihen në objektin e veprimtarisë së AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
J.ZH	Webe	-	11.09.2025

1. Objekti i Ankesës

J.Zh i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me objekt

"heqjen e përmbajtjeve online".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit J.ZH me objekt: *"heqjen e përmbajtjeve online". Dhe pretendohet se "në media online janë publikuar disa lajme që lidhen me një ngjarje të ndodhur në një periudhë kur gjendja e ankuesit ka qenë e rënduar"- dhe se ekspozimi ndaj këtyre materialeve e bën të vështirë rrugën drejt një jete të qëndrueshme dhe të shëndetshme".*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialeve u evidentua se një pjesë e materialeve si referencë publikimi kishin motorin e kërkimit "Google". Bazuar në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën

e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit, motori i kërkimeve "Google" nuk është nën juridiksionin e AMA-s.

Edhe nga verifikimi i linqeve të përcjellë nga ankuesi, rezultoi se materialet i cituara ishin artikuj të publikuar në mediat online. Sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (edhe me ligjin nr. 30/2023), neni 2 "Fusha e zbatimit", mediat online/portalet vijojnë të mbeten jashtë objektivit të veprimtarisë së AMA-s.

Në vijim, në lidhje me publikimet në rrjetet sociale "Facebook" dhe "Instagram", ju sqarua se në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të rrjeteve sociale të "Meta"-s, në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion veprimi mbi të

Për rrjedhojë nuk mund të marrë masa ndaj materialeve të publikuara prej tyre.

Sa i takon publikimeve në platformën e shpërndarjes së videove "YouTube", në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të kësaj platforme në Republikën e Shqipërisë, sërish

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion mbi të.

Mbi publikimet në platformën "TikTok", në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 06.03.2025, i cili ndalon aksesin zyrtar në platformën TikTok në Republikën e Shqipërisë,

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka mundësi institucionale për të ndjekur apo raportuar përmbajtje në këtë platformë.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi se çështja nuk mund të trajtohej për mungesë kompetencash.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
S.L.	Portle	-	11.09.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetases S.LL me objekt me objekt "një lajm të publikuar në disa portale".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases S.LL me pretendimin se: "disa media online (gijotina.com,

pamfleti.net, egnatiaNews.com, www.balkanweb.com kanë publikuar të dhënat e saj personale dhe ajo kërkon që ky lajm të hiqet nga rrjeti".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive evidentoi se materialet janë publikuar në mediat online. Referuar nenit 2, të ligjit nr.97/2013, mediat online dhe portalet janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.M.	Tik Tok	-	18.09.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetases R. M me objekt me objekt platformën tik tok.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases R.M ku ankuesja denoncon se *"një faqe në platformën "TikTok", e cila sipas pretendimeve të saj ka marrë pa leje videot personale dhe i ka shpërndarë në rrjetin "Instagram", duke gjeneruar komente denigruese"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke mirëkuptuar ndjeshmërinë e situatës së paraqitur, ju bëjmë me dije sa vijon:

Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, konkretisht nenit 2 "Fusha e zbatimit", ky ligj zbatohet vetëm për transmetimet e mediave audiovizive lineare, jolineare dhe

shërbimet mbështetëse të tyre. Mediat online dhe portalet vijojnë të jenë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Në lidhje me publikimet në "TikTok", ju informojmë se, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 06.03.2025, i cili ndalon aksesin zyrtar në këtë platformë në Republikën e Shqipërisë, AMA nuk ka mundësi institucionale për të monitoruar apo raportuar përmbajtje në këtë rrjet social.

Pas amendimeve të fundit të ligjit nr. 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit (vendimi nr. 60, datë 10.07.2023, i amenduar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024), është parashikuar që platformat e shpërndarjes së videove të përfshihen në juridiksionin e AMA-s. Megjithatë, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet aktualisht, për sa kohë që platformat ndërkombëtare nuk janë të regjistruara dhe nuk kanë përfaqësi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Duke ju falënderuar për besimin e treguar tek institucionet rregullatore, ju sigurojmë se Këshilli i Ankesave do të vijojë të trajtojë me seriozitet çdo

ankesë që lidhet me shkelje të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si edhe të Kodit të Transmetimit, si dhe do të sensibilizojë të gjithë ofruesit e

shërbimeve audiovizive mbi rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet ligjore që burojnë nga mosrespektimi i tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.LL	Instagram JOQ	-	23.09.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit R. LL me objekt me platformën Instagram dhe portalin JOQ.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit R.LL ku ankuesi denoncon se ""një video është postuar në platformën Instagram, e cila më pas është publikuar nga portali "JOQ", duke cenuar privatësinë e ankuesit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, konkretisht nenit 2, "Fusha e zbatimit", ky ligj zbatohet vetëm për transmetimet e mediave audiovizive lineare, jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Mediat online dhe portalet vijnë të mbeten

jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Pas amendimeve të fundit të ligjit nr. 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit (miratuar me vendimin nr. 60, datë 10.07.2023, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024), është parashikuar që platformat e shpërndarjes së videove të përfshihen në juridiksionin e AMA-s. Megjithatë, kjo dispozitë nuk është ende e zbatueshme, për sa kohë që platformat ndërkombëtare nuk janë të regjistruara dhe nuk kanë përfaqësi ligjore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Duke mirëkuptuar ndjeshmërinë e situatës së paraqitur dhe duke ju falënderuar për besimin e treguar ndaj institucionit tonë, ju sigurojmë se Këshilli i Ankesave do të vijojë të trajtojë me seriozitet çdo ankesë që lidhet me shkelje të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, si edhe të Kodit të Transmetimit. Gjithashtu, AMA do të vijojë të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive mbi rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet ligjore që burojnë nga mosrespektimi i tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
I.D	Facebook	-	30.09.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit

I.D me objekt një postim në rrjetin social "Facebook".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit I.D ku ankuesi kërkonte informacion në lidhje me një postim në platformën Facebook të bashkisë Përmet.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në cilësinë e tij si autoritet i pavarur rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive si edhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, e ushtron veprimtarinë e tij bazuar dhe në zbatim të ligjit nr. 97/2013, "Për

mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 2, "Fusha e zbatimit", i ligjit nr.97/2013 përcakton se : "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.". Mediat online dhe portalet janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Për rrjedhojë, Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk mund të ketë informacion në lidhje me identitetin e subjektit zotërues/drejtues të portalit elektronik "Bashkësia Përmet" në rrjetin social "Facebook.

Në vijim, në lidhje me publikimet në rrjetet sociale "Facebook" dhe "Instagram", ankuesit iu sqarua se në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të rrjeteve sociale të "Meta"-s, në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion veprimi mbi të për rrjedhojë nuk mund të marrë masa ndaj materialeve të publikuara prej tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.L	Tik Tok	-	10.10.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit

A.L me objekt *"një video të publikuar në platformën TikTok"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit A.L i cili pretendon *"se gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale, veçanërisht në platformën TikTok, është përhapur në mënyrë të pakontrolluar ndaj pakicave kombëtare, kryesisht ndaj komuniteteve romë dhe egjiptianë. Gjithashtu, ju theksoni se kjo formë komunikimi nxit përjashtimin social dhe dëmton psikologjikisht, emocionalisht dhe moralisht anëtarët e këtyre komuniteteve, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në jetën e tyre të përditshme"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke mirëkuptuar ndjeshmërinë tuaj

për këtë çështje, ju bëjmë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 06.03.2025, i cili ndalon aksesin institucional në platformën TikTok në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk ka mundësi ligjore dhe teknike për të monitoruar, ndjekur apo raportuar përmbajtje të publikuara në këtë platformë.

Për pasojë, AMA nuk ushtron kompetenca rregullatore mbi rrjetet sociale, të cilat nuk klasifikohen si ofrues të shërbimeve mediatike audiovizive në kuptimin e ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Megjithatë, mbrojtja e të drejtave të pakicave kombëtare dhe etnike, si pjesë përbërëse e të drejtave themelore të njeriut, si dhe e detyrimeve të Ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA) dhe platformave të shpërndarjes së videove, ka qenë dhe mbetet një prioritet i qëndrueshëm për Autoritetin e Mediave Audiovizive.

Ky angazhim pasqyrohet si në monitorimin e përmbajtjeve mediatike,

ashtu edhe në administrimin e ankesave të publikut që lidhen me diskriminimin, përjashtimin social dhe gjuhën e urrejtjes.

Në kushtet aktuale, zbatimi i kësaj përgjegjësie institucionale përballet me kufizime administrative, që burojnë nga mungesa e përfaqësimit zyrtar të

platformave të shpërndarjes së videove në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga pamundësia për të vendosur bashkëpunim të drejtpërdrejtë dypalësh me platformën TikTok, për shkak të ndalesës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave të sipërcituar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.N.	RRJETET	-	22.10.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit

B.N me objekt: "Në emisionin mbi bullizimin në rrjetet sociale".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit B.N e cili pretendon: "Se gjatë një emisioni i transmetuar në rrjetet sociale pretendoni se kjo temë nuk është trajtuar me rëndësinë e duhur".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në cilësinë e tij si autoritet i pavarur rregullator në fushën e shërbimeve të

transmetimeve audio dhe audiovizive si edhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, e ushtron veprimtarinë e tij bazuar dhe në zbatim të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 2, "Fusha e zbatimit", i ligjit nr.97/2013 përcakton se : "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Në vijim, në lidhje me publikimet në rrjetet sociale "Facebook" dhe "Instagram", ankuesi iu sqarua se kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të rrjeteve sociale të "Meta"-s, në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion veprimi mbi të për rrjedhojë nuk mund të marrë masa ndaj materialeve të publikuara prej tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.GJ.	Facebook	-	05.11.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasës

A. Gj me objekt: *"Rrjetet sociale"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasës A. Gj e cila pretendon se: *"Publikimi në platformën "brryli.broadëay", shpërndarë gjithashtu në rrjetet sociale më 22.10.2025, sipas ankueses janë përdorur shprehje fyese dhe akuza të pavërteta ndaj saj, të cilat e dëmtojnë dhe përbëjnë shpifje"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përgjigje të kërkesës suaj për masat ligjore që mund të merren për ndalimin e transmetimit dhe vendosjen e sanksioneve përkatëse, dëshirojmë të sqarojmë sa vijon:

Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht Neni 30/1, i cili përcakton se "Ofruesi i shërbimit të platformave të shpërndarjes së videove është në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë kur zyra apo struktura drejtuese e tij është në territorin e Republikës së Shqipërisë". Rrjetet sociale "Facebook" dhe "Instagram", pjesë e platformës "Meta", nuk janë regjistruar në territorin e Shqipërisë dhe, për këtë arsye, ato nuk bien nën juridiksionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.Y	Portal	Tirana Times	12.11.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit

L.Y me objekt: *"Portalin Tirana Times"*

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit L.Y, *"Në lidhje me publikimin e një artikulli ku pretendohet se "përmban informacione të rreme". Ndaj kërkon heqjen ose korrigjimin e informacionit si dhe publikimin e një sqarimi"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Së pari, Autoriteti i Mediave Audiovizive

(AMA), si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive, vepron në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 97/2013.

Bazuar në dispozitat e ligjit Nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 2 "Fusha e zbatimit", përcakton se "Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Mediat online dhe portalet janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në rastin konkret, "Tirana Times". Ndaj dhe mediat online, vijojnë të mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit. Për këtë iu sugjerua ankuesit që në mungesë të kompetencave që njeh ligjvënësi Autoritetit të Mediave Audiovizive ai mund t'i drejtohej burimit parësor të publikimit të artikullit, "Tirana Times".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.K	Tik Tok	-	10.12.2025

1. Objekti i Ankesës

D.K iu drejtua Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me përdorimin e të dhënave të tij personale në "Tik Tok".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankuesi kishte dërguar materiale ë cilat

lidheshin me përdorimin e paautorizuar të identitetit të tij si (foto dhe të dhëna personale) në platformën TikTok. Por, Autoriteti në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 06.03.2025, i cili ndalon aksesin zyrtar në platformën TikTok në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) vijon të ketë të pamundur ndjekjen apo raportimin e përmbajtjeve të dëmshme në këtë platformë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
GJ.C.	PORTALE	Pamfleti	10.12.2025

1. Objekti i Ankesës

GJ.C i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me objekt një shkrim të publikuar në portalin "Pamfleti".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit Gj.C i cili ankohej se: *"Më datë 22 Tetor 2025, Portali "Pamfleti" ka publikuar një shkrim të pavërtetë, fyese dhe denigruese ndaj ankuesit, duke përdorur emrin e tij në titull dhe duke i atribuar deklarime të rreme që cenojnë dinjitetin, jetën private dhe figurën profesionale", ndaj kërkon nga AMA fshirjen e artikullit dhe marrjen e masave administrative e ligjore përkatëse".*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të saj, ankuesit iu bë me dije se referuar ligjit nr.97/2013, *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, konkretisht nenit 2, *"Fusha e zbatimit"*, përcakton se *"Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove"*. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar – qoftë offline apo online, edhe pas ndryshimeve ligjit nr. 97/2013 me ligjin nr. 30/2023, mediat online (portalet), vijojnë të mbeten jashtë juridiksionit të AMA-s, objekti i ankesës bie jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

4

Ankesa jashtë

afatit

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.S	Report TV	Live me Odetën	10.09.2025

1. Objekti i Ankesës

E.S dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me objekt

"Emisioni televiziv "Live me Odetën" transmetuar në Report TV".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialeve të përcjella nga ankuesi, u konstatua se :

- Së pari, publikimi i linkut nuk është më i disponueshëm.

- Së dyti, rubrika/emisioni "Live me Odetën", për të cilin pretendoni se është transmetuar në Report TV me datë 09/09/2025, nga verifikimet tona, nuk rezulton të jetë transmetuar në OSHMA-në, Report TV.
- Së treti, ju informojmë se rubrika "Live me Odetën", publikohet në platformën e shpërndarjes së videove "YouTube", për të cilën Autoriteti i Mediave Audiovizive në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të kësaj platforme në Republikën e Shqipërisë nuk ka juridiksion mbi të.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.Z.	Portal	Piranjat	12.11.2025

1. Objekti i Ankesës

K.Z i drejtoi një ankesë, Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me objekt:

"Portalin Piranja".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit K.Z, *"I cili kërkon nga Autoriteti i Mediave Audiovizive: "fshirjen dhe/ose bllokimin e gjobaxhinjve që kanë publikuar videon"- me pretendimin se janë: "duke mashtruar publikun dhe duke përdorur foton time, pasi jam ne proces gjyqësor me këta gjobaxhinj, por video është ende online."*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Referuar Ligjit Nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 52, "Shqyrtimi i ankesave", "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë". Bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar përmbajtja audiovizive, së cilës ju i referoheni nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi bie jashtë afateve ligjore të parashikuara.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.S.	Syri TV Top Channel	-	27.11.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetases E.S me objekt: *"Fshirjen e publikimeve online të vitit 2021 që lidhen me arrestimin e saj"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases E.S e cila kërkon nga Syri tv të fshijë një material që ka të bëjë me arrestimin e saj në vitin 2021.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vlerësimin e Këshillit, veprimtaria audiovizive duhet të jetë në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenin 46/4(d) të Ligjit 97/2013, që kërkon respektimin e të drejtave të individit në raportimet audiovizive, si dhe me detyrimet e Kodit të Transmetimit, nene 2.11 dhe 2.12, që kërkojnë trajtim të drejtë, proporcional dhe të përditësuar të informacionit, veçanërisht kur ai

lidhet me reputacionin e individëve.

Ankuesja i referohej "të drejtës për t'u harruar" e mbrojtur veçanërisht nga Ligji nr. 124/2024 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 16 ("E drejta për t'u harruar"), i cili parashikon fshirjen e të dhënave kur ato nuk përfaqësojnë realitetin juridik aktual dhe kanë efekt të pajustificuar negativ në jetën e individit. Vendimi i formës së prerë për pushimin e çështjes bie ndesh me përmbajtjen e publikuar në vitin 2021, duke krijuar një mospërputhje të qartë midis informacionit aktual dhe asaj që vijon të qarkullojë online.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave, mbi bazën e standardeve editoriale dhe detyrimeve ligjore të lartpërmendura, i rekomandoi OSHMA-s rishikimin e publikimit dhe marrjen e masave editoriale të nevojshme për të shmangur vazhdimin e pasqyrimin të një informacioni të tejkaluar dhe potencialisht dëmtues, duke reflektuar statusin e ri juridik të ankuseses.

Ky rekomandim synoi mbrojtjen e interesit publik, respektimin e të drejtave të individit dhe përputhjen me standardet ligjore dhe etike të raportimit audioviziv.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.LI	YouTube	Live me Odetën	09.12.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetases E.LI me objekt: *"Emisioni live me Odetën"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases E.LI e cila pretendonte për: *"shpifje, publikim materialesh të njëanshme dhe cenim të privatësisë nga emisioni", ndaj kërkonte marrjen e masave nga Autoriteti i Mediave Audiovizive"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, strukturë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive,

evidentoi se materiali i referuar është publikuar në kanalin e shpërndarjes së videove "YouTube".

Bazuar në ligjin Nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (edhe me ligjin nr. 30/2023) konkretisht, neni 2 i ligjit i jep AMA-s si autoritet rregullator kompetencë edhe mbi veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose të PSV-ve.

Megjithatë, në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të platformës You Tube në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion mbi të.

Duke mirëkuptuar shqetësimin për të cilin ankoheni, sqarojmë se në kushtet kur mungojnë akoma mekanizmat veprues ndaj këtyre platformave, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audioviziv nuk mund të veprojë ndaj tyre.

5

Komunikime tregtare

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.D.	TV Teuta	Live me Odetën	25.08.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit

A.D me objekt *"lidhur me transmetimin nga televizioni Teuta të një filmi në gjuhën angleze me titra në një gjuhë të huaj jo shqipe"*

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit A.D lidhur me *"lidhur me transmetimin nga televizioni Teuta të një filmi në gjuhën angleze me titra në një gjuhë të huaj jo shqipe"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Sipas nenit 18, pika 2, shkronja "dh" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ndër objektivat e AMA-s është "nxitja e zhvillimit të shërbimeve të transmetimit dhe programeve në gjuhën shqipe". Ky përcaktim përbën një orientim programor për të forcuar përdorimin dhe promovimin e gjuhës shqipe në media. Megjithatë, ligji nuk vendosnjë detyrim të drejtpërdrejtë dhe sanksionues për Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (AMSP/OSHMA) që çdo përmbajtje e transmetuar në gjuhë të huaj të përkthehet domosdoshmërisht në shqip.

Për rrjedhojë, transmetimi në fjalë nuk përbën shkelje të dispozitave të ligjit nr. 97/2013 dhe të akteve nënligjore përkatëse, pasi detyrimi i OSHMA-ve lidhet kryesisht me respektimin e kushteve të licencës dhe autorizimeve, si dhe me mosshkeljen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.H.	Top Channel	Reklama	27.10.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetases A.H me objekt: *"Përdorim të gjuhëve të huaja, si anglisht dhe italisht në publicitet dhe materiale promociionale të disa kompanive"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases A.H e cila pretendon: *"Se ka përdorim të gjuhëve të huaja, si anglisht dhe italisht në publicitet dhe materiale promociionale të disa kompanive"*. Konkretisht: *"publiciteti për dysheqet në gjuhën italiane...publiciteti i kompanisë Foodini në anglisht...emisione dhe programe televizive, përdoren terma në gjuhën angleze, si në emisionin Ëake Up në Top Channel"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke mirëkuptuar shqetësimin, për të

cilin Ju ankoheni, ju bëjmë me dije se Autoriteti i Mediave ka pasur dhe ka vazhdimisht në fokus aspektet e Gjuhës Shqipe të folur dhe të shkruar. AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator ka sjellë në vëmendje operatorëve mediatikë audiovizivë edhe respektimin e Gjuhës Shqipe në çdo transmetim audioviziv.

- Sa më sipër, ju bëjmë me dije se në procesin e monitorimit dhe shqyrtimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, Autoriteti i Mediave Audiovizive, (AMA), u është rikthyer dhe çështjeve të respektimit të standardit të shqipes së folur dhe të shkruar nga redaksitë audiovizive.
- Verifikimi i përmbajtjeve të transmetuara audiovizive nga Autoriteti bazohet në kërkesat e ligjit 97/2013, Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar, në kërkesat e Kodit të Transmetimit si edhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.
- Konkretisht Autoriteti i Mediave Audiovizive ka dy mënyra për verifikimin e përmbajtjeve të transmetuara:
 - duke monitoruar

kryesisht ex officio, • duke shqyrtuar ankesat e publikut.

- Nëpërmjet këtyre kanaleve të verifikimit, Autoriteti ka evidentuar tekste (informacione, tituj, titrat e përkthimeve etj.) të cilat shkruhen me nxitim, duke mos respektuar rregullat bazë të standardit të shqipesçka bie në kundërshtim me zbatimin e parimeve themelore dhe kërkesave të ligjit 97/2013, neni 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", dhe të Kodit të Transmetimit të AMA-s, seksioni 1, "Parimet themelore", të cilat përcaktojnë detyrimin e OSHMA-ve për përdorimin e standardit letrar të gjuhës shqipe.

Sa herë, që nga shqyrtimi i materialeve audio dhe audiovizive janë evidentuar shkelje, është vijuar menjëherë me marrjen e masave administrative paralajmëruese ose sanksionuese, përputhur me natyrën e shkeljes.

Përtej kësaj, prej më shumë se një viti, përveç përmbushjes së detyrimeve të veta ligjore, nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura, Autoriteti ofron rregullisht dhe këshillat e specialistëve të gjuhës për çështje të respektimit të standardit të shqipes së folur dhe të shkruar nga redaksitë e mediave audiovizive.

Sakaq, gjatë vitit 2024 AMA ka vijuar fushatën ndërgjegjësuere dhe informuese "Fol shqip" me qëllimin e përmirësimit të gjuhës së folur dhe të shkruar në transmetimet audio/audiovizive, fushatë që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e standardeve profesionale të redaksive. Fushata nisi në fillim të vitit 2024, me një tryezë gjithëpërfshirëse gazetarë-gjuhëtarë, e titulluar, "Fol Shqip-Të mbrojmë dhe të duam gjuhën shqipe", dhe kishte si qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve të medias për mbrojtjen e gjuhës shqipe nga fjalë e huaja.

Periodikisht AMA ka publikuar në ëbsite-n zyrtar dhe në llogaritë e saj në rrjetet sociale, fjalë të huaja të përdorura nga gazetarët apo dhe formulime të pasakta, të shoqëruara këto me gjegjëset në shqip dhe format e dhura gjuhësore. Gjetjet e kësaj nisme reflektohen edhe në emisionin "Fol Shqip shoë" që transmetohet në Kosovë dhe Maqedoni.

Nëkuadërtëpërmbushjessëdetyrimeve që burojnë nga dispozitat ligjore, AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator do të vijojë monitorimet mbi përdorimin e gjuhës shqipe duke e vlerësuar këtë aspekt me shumë rëndësi në edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për respektimin e standardit në të folur dhe në të shkruar.

6

Ankesa të ndryshme
dhe kërkesë për
informacion

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.P	Panorama.com.al		04.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë nga z.K.P me objekt publikimin në portalin "Panoram.com.al" e pamjeve nga lokalit të tij, pa autorizimin e këtij të fundit.

2. Administrimi i Ankesës. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave administroi ankesën e mbërritur pranë AMA-s, ku sipas shtetasit K.P, portali "Panorama.com.al" ishte publikuar foto të lokalit të

ankuesit pa marrë më parë një miratim e tij. Gjithashtu ankuesi pretendonte se këto pamje janë përdoruar për një lajm ku flitet për zaptimin në mënyrë të paligjshme të hapësirave publike. Por ankuesi pretendonte se kjo nuk ishte e vërtetë.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 2, "Fusha e zbatimit", "Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Mediat online dhe portalet janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.K	RTSH	7 pa 5	19.07.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit

A.K me objekt një material audioviziv të transmetuar në Radio Televizionin Publik Shqiptar.

2. Administrimi i Ankesës.

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, administroi ankesështetasit A.K. i cili pretendonte, se *"RTSH, gjatë muajve të fundit ka treguar një fokus të njëanshëm, pasi në diskutimet për konfliktin Izrael-Palestinë flasin pothuajse vetëm persona me qëndrime pro Izraelit, pa pasur hapësirë të mjaftueshme për këndvështrime të tjera..."*, *"... ndërkohë që shoqëria shqiptare ka treguar solidaritet të qartë për çështjen palestineze nëpërmjet protestave dhe aktiviteteve publike"*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive

garanton lirinë editoriale dhe lirinë e shprehjes në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë (Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4). AMA nuk ndërhyr në politikën editoriale të ofruesve të shërbimeve audiovizive, publike apo private. Personat fizikë apo juridikë, të cilët pretendojnë se janë drejtpërdrejt të prekur, kërkojnë ushtrimin e së drejtës së përgjigjes (Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 53).

2. Në një sistem demokratik, analistët dhe të ftuarit në studio gëzojnë lirinë e shprehjes, e cila mbrohet nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Mendimet e tyre janë personale dhe nuk mund t'i atribuohen automatikisht subjektit audioviziv si qëndrim institucional. Ndërhyrja e AMA-s në përzgjedhjen e analistëve apo në kufizimin e mendimeve të shprehura prej tyre do të cenonte drejtpërdrejt parimin e lirisë së shprehjes dhe të pluralizmit të mendimeve.

3. Në raste konfliktesh

ndërkombëtare, përfshirë konfliktin Izrael–Palestinë, mediat shqiptare apo të huaja, mbështeten në ato burime, që janë të aksesueshme rast pas rasti edhe pse - për shkak të natyrës së kufizuar të informacionit në zona dhe situata konflikti – pasqyra ndodh të mos jetë në çdo rast shteruese dhe e shumanshme, pavarësisht se tabloja e përgjithshme në kohë dhe hapësirë e garanton këtë. Edhe RTSH, si çdo media tjetër shqiptare, raporton mbi bazën e këtyre burimeve, çka, në vetvete, nuk përbën shkelje ligjore, por është pjesë e lirisë editoriale.

4. Publiku ka të drejtën dhe domosdoshmërisht lirinë e vet, të vlerësojë informacionin e marrë dhe ta plotësojë atë me burime dhe këndvështrime të tjera, nëse ndjen nevojën apo ka ndjesinë, se duhet ta bëjë këtë.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave, si pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive, sqaroi, se AMA nuk ka kompetencë ligjore të ndërhyjë në përzgjedhjen e burimeve, të ftuarve apo të këndvështrimeve editoriale të ofruesve të shërbimeve audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.M	TV KLAN	STOP	10.09.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasës

E.A me objekt "*me objekt emisionin investigativ "Stop", transmetuar në televizionin Klan*".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive evidentoi se mungojnë elementët për vijimin e trajtimit të ankesës. Ndaj dhe iu kërkua plotësimi i elementëve për vijimin e trajtimit të saj.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S.M.	TV KLAN	Stop	11.11.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e shtetasit

S.M me objekt: *"një material i publikuar në emisionin 'Stop', në TV Klan, për punimet që janë bërë te Ura e Vashës, Bashkia Klos"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetasit S.M i cili kërkonte që *"Autoriteti i Mediave Audiovizive ta vinte në kontakt me TV Klan, me qëllim sqarimin e çështjes së ngritur"*. Në përgjigje të kërkesës Këshilli i Ankesave i vendosi në dispozicion të dhënat zyrtare të kontaktit të TV Klan.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Y.G.	-	-	10.12.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrtoi ankesën e shtetasës Y.G me objekt intervistimin pa dëshirë dhe më tej publikimin pa konfirmimin e saj.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në ankesën drejtuar KA-së, qytetari pretendonte publikimin e materialit, ndërkohë që nga verifikimi rezultoi se nuk kishte një të tillë, por kërkohej mospublikimi i tij. Ndaj ankueses iu bë me dije se AMA, në cilësinë e tij si autoritet i pavarur rregullator, në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Sipas dispozitave të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën

e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 2 "Fusha e zbatimit", përcakton se "*Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre*". Pra, Autoriteti është përgjegjës për monitorimin e transmetimeve audiovizive lineare, transmetimeve audiovizive jolineare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Për rrjedhojë, aspektii "*mostransmetimit të materialit si dhe mungesa e edukatës së zonjës në foto*" nuk bien në kompetencat ligjore të AMA-s dhe nuk janë objekt trajtimi prej tij.

AMA është autoritet rregullator, veprimtaria dhe kompetencat vendimmarrëse të të cilit përcaktohen nëpërmjet dispozitave të ligjit nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Ky ligj, apo edhe aktet nënligjore të dala për dhe në zbatim të tij, nuk parashikojnë ndërhyrjen e Autoritetit në pretendime që dalin nga materiale të patransmetuara në median audiovizive në Shqipëri.

